



PRANUAR ME: 22/07/2026
ACCEPTED ON:
PRIMJENO: 02/213



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Nr. 02/_____
Datë:14.07.2026

Procesverbal
i mbledhjes së -I-(parë) të rregullt të Komitetit për Komunitete

Koha: 14.07.2026 ora 09:00

Vendi :Salla e mediave

Të pranishëm:Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala si dhe
anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e hedhi në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1. Propozimet për projektbuxhetin për vitin 2027
2. Takim me drejtoreshën e Arsimit, znj. Arbëresha Krasniqi

Rendi i ditës u miratua unanimishtë nga të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete .
Rezultati i votimit:4 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Propozimet për projektbuxhetin për vitin 2027

Kryesues i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala:Të nderuar anëtarë të Komitetit,unë e hapi këtë pikë të rendit të ditës për diskutim por në të njëjtën kohë ju ftojë që të propozoni nëse keni ndonjë projektë konkrretë zhvillimor që është në interes për komunitete apo nëse keni ndonjë kërkesë që është e rëndësishme për vendbanimin e juaj ju ftojë të ngritni të gjitha nevojat dhe shqetësimet dhe ne se bashku me organet kompetente të komunës do të bashkëpunojmë me qëllim të krijimit të një jetese sa më të mirë dhe të barabartë për të gjitha komunitete.

Hafir Rexha anëtarë i Komitetit për Komunitete:Përsëritet, i nderuar Kryesues, të nderuar anëtarë. Për momentin unë nuk kam ndonjë propozim, disa rrugë në fshatin tim që kanë pasur nevojë me u asfaltuar dhe riparuar ato tani janë duke u punuar, në Malishevë ka projekte të mëdha të cilat janë duke u realizuar dhe këto pa dyshim që i shërbejnë të gjitha komuniteteve dhe ne jemi mirënjohës dhe falenderues ndaj institucionave tona për këto shërbime që na ofrojnë.

Naser Malisheva anëtarë i Komitetit për Komunitete:Përsëritet Kryesues, të nderuar kolegë. Në vendbanimin ku unë jetoj kemi pasur problem në disa rrugë që janë dëmtuar, kurse këtë vit kanë filluar me i riparuar, kërkesa të tjera nuk kemi për arsyeje se në Malishevë gjdo ditë janë duke punuar për zhvillimin e këtij vendi.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala:Ju faleminderit, unë edhe një herë ju rikujtoj që mos të hezitoni për gjdo shqetësim dhe nevojë ta ngritni dhe ne se bashku do ta trajtojmë.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Takim me drejtoreshën e Arsimit, znj. Arbëresha Krasniqi

Kryesues i Komitetit për Komunitete z. Fitim Shala:Të nderuar anëtarë të Komitetit, unë Drejtoreshën e Arsimit znj. Arbëresha Krasniqi realisht e kam kontaktuar pak me vonesë para dy dite, ajo pohoj që ishte e gatshme të merrë pjesë mirëpo agjenden e takimeve e kishte të ngarkuar dhe nuk kishte mundësi që sot të merrë pjesë në këtë takim mirëpo herën e ardhshme mbetet nga ana ime ta njoftoj më herët. Unë e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Hafir Rexha anëtarë i Komitetit për Komunitete:Meqenëse Drejtoresha e Arsimit znj. Arbëresha Krasniqi nuk është prezente në këtë takim, unë mendoj që ne si anëtarë të Komitetit për Komunitete me ju drejtu me një shkresë zyrtare Drejtoreshës së Arsimit për me na dhënë disa informata konkrete dhe të sakta lidhur me vijimin e nxënësve nëpër shkolla sepse është e nevojshme dhe domosdoshme që ne me qenë në dije.

A janë duke vijuar shkollimin të gjitha komunitet? A janë pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme të shkollës? A e kanë të siguar transportin? A ka fëmijë që e kanë braktisur shkollimin për shkak të kushteve të dobëta ekonomike? A ka fëmijë që janë të talentuar dhe kanë nevojë me i mbështetur më tuje?

Unë si anëtarë i Komitetit për Komunitete dëshiroj me qenë në dijeni se në qfarë kushte janë duke jetuar komunitetet pa dallim.

Në vitin e kaluar kam dëgjuar se ka fëmijë që e kanë braktisur mësimin dhe kjo aspak nuk është e mirë duke pasur parasysh që tani kushtet për shkollim janë më të avancuara për shembull librat me tekstete shkollore subvencionhen.

Naser Malisheva anëtarë i Komitetit për Komunitete:Unë punoj në shkollë të Kjeves nga komuniteti jonë janë gjashtë nxënës, një djalë dhe pesë vajza ata janë të pajisur me mjete shkollore dhe e vijojnë shkollimin me rregull gjdo ditë nuk kanë pasur asnjë pengesë deri tani.

Kryesues i Komitetit për Komunitete z.Fitim Shala:Nëse ka fëmijë që e kanë braktisur shkollimin duhet me marrë masa institucionale dhe ligjore,njëkohësishtë duhet me i njoftuarë prindërit apo kujdestarin e tyre përgjegjës për pasojat ligjore në rast se ata fëmijë nuk e vijnë në mësimin me rregull por edhe ne si Komitet për Komunitete nëse është e nevojshme do të vizitojmë në terren ato familje me qëllim që të gjitha komunitetet të kenë gjithë përfshirje në institucione pa dallim.

Por ne do ta ftojme Drejtoreshën e Arsimit znj.Arbëreshë Krasniqi atëherë do të kemi mundësi që të informohemi më saktësishtë.

Unë ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen dhe angazhimin tuaj.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i përfundoi punimet e mbledhjes rreth orës 09:30.

Malishevë Korrik,2026

Procesëmbajtsja

Kryesues i Komitetit për Komunitete

Fatlume Delija



Fitim Shala

